



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Legjislacion

Mbledhja nr. 93

Prishtinë, më 11.11.2013, në orën 12:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala S2

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion

Në mbledhje morën pjesë: Arben Gashi, kryetar, Behar Selimi, Arsim Bajrami, Ardian Gjini, Halit Krasniqi, Haki Demolli, Albulena Haxhiu, Gëzim Kelmendi dhe Sreten Ivanoviq.

Munguan: Mufera Shinik dhe Armend Zemaj.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Petrit Hysaj dhe Lejla Selimi – OSBE, Artan Canhasi – EULEX, Agim Sulaj – Lajm.net, Liridona Xhemajli – RTV 21 dhe Lumnije Murati – ZPRK.

Nga stafi i Komisionit për Legjislacion: Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni dhe Visar Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi, Arben Gashi, kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 16.9.2013;
3. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funkcional në Projektligjin nr. 04/L-205 për Agjencinë e punësimit të Republikës së Kosovës;
4. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari, propozoi që në të ndryshme të përfshihen edhe:

Njoftim me Punimin hulumtues për Projektligjin për aktet normative dhe njoftim me shkresën e Sadat Lekiqit, lidhur me intervistimin e kandidatëve për anëtar të KPMK-së.

Rendi i ditës u miratua me propozimet e kryetarit të Komisionit.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 16.9. 2013;

Kryetari konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalin nga mbledhja e mbajtura më 16.09. 2013, pa asnjë vërejtje.

3. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL, në Projektligjin nr. 04/L-205, për Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës;

Kryetari, e paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente në Projektligjin nr. 04/L-205, për Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës dhe kërkoi nga anëtarët që të deklarohen nëse kanë ndonjë vërejtje për projektligjin dhe amendamentet e propozuara.

Meqë nuk kishte vërejtje, Kryetari konstatoi se Komisioni, në mënyrë unanime vendosi që Komisionit FunkSIONAL t'ia paraqesë këtë

Rekomandim

1. Projektligji nr. 04/L-205 për Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës dhe amendamentet e propozuara, nuk janë në mospajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.
2. Projektligji me amendamentet e propozuara, mund t'i procedohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

4. Të ndryshme.

a. Njoftim me punimin hulumtues në Projektligjin për aktet normative.

Kryetari, i njoftoi me punimin hulumtues në Projektligjin për aktet normative, për të cilin kam kërkuar që ta kemi një punim hulumtues, lidhur me atë se sa shtete në rajon dhe shtete anëtare të BE-së kanë ligj të tillë. Ashtu siç edhe e keni pa, shumë pak shtete, përkatësisht vetëm dy shtete kanë ligj të tillë. Andaj, unë nuk do të isha i mendimit që ne të kemi një ligj të tillë, duke pasur parasysh edhe përmbajtjen e tij të dobët.

Albulena Haxhiu, theksoi se si komision jemi ngutur pak, kur kemi rekomanduar miratimin në parim, dhe nga ky punim shohim se edhe vendet e rajonit nuk e kanë këtë projektligj dhe mendoj se nuk duhet të ngutemi me të sepse ka shumë mangësi, duke filluar nga përkufizimi. Është më mirë të mos e kemi këtë ligj se sa ta kemi një ligj me kaq mangësi.

Arsim Bajrami, duke u ndërlidhur me parafolësit, tha se projektligji akoma nuk ka kaluar në lexim të parë dhe shpresoj se në seancën vijuese është përfshirë në agjendë. Edhe unë e kam lexuar projektligjin

dhe kam shumë rezerva sa i përket objektivit, por, ne si Komision, nuk duhet ta lëshojmë rastin që atë ta përmirësojmë pas leximit të parë. Mendoj se për këtë ligj ka nevojë, nuk kanë nevojë ndoshta Sllovenia e Kroacia, që janë pjesë e BE-së dhe standardet e ligjeve janë ndoshta në nivel, por te ne mendoj se ka nevojë. Mendoj se ne duhet ta marrim këtë analizë dhe ta procedojmë më tutje, dhe ta rishkruajmë atë dhe t'ia përshtatim nevojave të Kuvendit të Kosovës.

Do të ishte shumë mirë, që ne t'ia lëmë të gatshtëm një ligj të tillë gjeneratës së ardhshme që do të punojë në këtë komision. Propozoj që ta kalojmë në lexim të parë, të formojmë grupin punues e t'i japim vërejtjet tona dhe se mund ta bëjmë një ligj të mirë.

Kryetari konstatoi se është vlerësim i përgjithësim që Projektligjit të kaloj leximin e parë dhe të amendamentohet konform procedurave të rregullta.

b. Shkresa e Sadat Lekiqit, lidhur me intervistimin e kandidatëve për anëtarë të KPM-së.

Kryetari i njoftoi për shkresën e Sadat Lekiqit, i cili ka bërë njoftimin për komisionin Ad- hoc, për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të KPMSHK-së, lidhur me disa vendime të marra nga ky institucion.

Komisioni vendosi që shkresa ti procedohet Komisionit Ad-hoc, për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës, në momentin e formimit nga Kuvendi.

Mbledhja përfundoi në orën 12:40

Kryetari i Komisionit

E përgatiti:

Stafi Mbështetës i Komisionit

Arben Gashi